

Video ekskluzive/ Vrau babë e bir në Grykë Zezë të Lezhës katër muaj më parë, kapet autori i ngjarjes (emri)

🕒 16/12/2022 11:06



Policia e Lezhës në bashkëpunim me forcat Renea ka bërë të mundur lokalizimin dhe kapjen e autorit të dyshuar për vrasjen e dyfishtë të ndodhur në muajin Gusht në Grykë Zezë të Lezhës.

Gazetarja Brixhilda Deda bën me dije për Top Channel se Besnik Pjetri, autori i dyshuar për vrasjen e dyfishtë të babë e bir Besnik dhe Pjetër Përrjaku, është shoqëruar pak minuta më parë në ambientet e komisariatit të Lezhës, nën masa të rrepta sigurie.

Pjetri, dhëndri i viktimave, ishte në kërkim nga policia e shtetit që prej fundit të muajt gusht.

Si ndodhi ngjarja?

Vrasja e dyfishtë ndodhi pak para mesnatës së datës 30 gusht në fshatin Grykë Zezë të Lezhës, ku pas sherreve të vazhdueshme pas divorcit me gruan, Besnik Pjetri vendos të vrasë babanë dhe vëllanë e bashkëshortes. Pasi janë kthyer nga një darkë familjare, ata janë drejtuar për në shtëpi ku si duket autori i dyshuar iu ka bërë pritë duke i ruajtur pranë banesës së tyre.

Burime të afërta nga familja kanë bërë me dije se në momentin që viktimat janë futur në banesë, autori ka hapur derën dhe ka qëlluar drejt tyre në korridorin e shtëpisë ku ka rezikuar dhe familjarë të tjerë.

Dyshohet se shkak për konfliktin janë bërë vajzat mes çiftit të divorcuar, të cilat mendohet se pas ndarjes nuk i ka takuar. Po ashtu burime bëjnë më dije çifti ka pasur konflikte të vazhdueshme edhe pse ishin divorcuar 6 vite më parë.

Njoftimi i Policisë:

RENEA kap dhe vë në pranga një shtetas shumë të kërkuar për vrasje të dyfishtë me armë zjarri.

Finalizohet operacioni policor i koduar "Fundi i arratisë", i zhvilluar në kushte të vështira terreni dhe atmosferike.

Operacioni, i finalizuar si rezultat i ndërhyrjes profesionale të shërbimeve të RENEA-s dhe punës gjurmuese-policore të strukturave hetimore dhe operacionale të Policisë së Lezhës.

Lokalizohet në një banesë të braktisur në Kaçinar, Mirditë, kapet dhe vihet në pranga 49-vjeçari i shumëkërkuar për vrasje të dyfishtë me armë zjarri.

I ndaluar vrau babanë dhe vëllanë e ish-bashkëshortes së tij, më datë 29.08.2022, në banesën e tyre, në Grykë-Zezë, Lezhë.

Shërbimet e Policisë së Lezhës, në vijim të punës intensive gjurmuese-policore, në bashkëpunim me Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për kapjen dhe vënien në pranga të autorit të shumëkërkuar të vrasjes së dyfishtë, me armë zjarri, të ndodhur më 29.08.2022, në Grykë-Zezë, Lezhë, ku u vranë shtetasit P.P., 56 vjeç dhe G.P., 32 vjeç (babai dhe vëllai i ish-bashkëshortes së autorit), mbështetur nga inteligjencia informative, si dhe falë ndërhyrjes profesionale nga shërbimet e RENEA-s, organizuan dhe finalizuan operacionin policor të koduar "Fundi i arratisë", të zhvilluar në një terren me kushte tejet të vështira gjeografike dhe atmosferike.

Si rezultat i këtij operacioni, falë kërkimeve të pandërprera dhe ndjekjes intensive, duke përdorur forma dhe teknika speciale hetimi, u bë i mundur lokalizimi në një banesë të braktisur, në fshatin Kaçinar, Mirditë, si dhe kapja e vënja në pranga e shtetasit:


– B. P. (P.), 49 vjeç, banues në Troshan, Lezhë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë i ka caktuar 49-vjeçarit, në mungesë, masën e sigurisë "Arrest në burg", pasi nga veprimet hetimore, të kryera nën drejtimin e Prokurorisë së Lezhës, rezultoi se 49-vjeçari, më datë 29.08.2022, për shkak të një konflikti me familjarët e ish-bashkëshortes së tij, ka vranë me armë zjarri shtetasit P.P. dhe G.P. (babai dhe vëllai i ish-bashkëshortes së tij).

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprime të mëtejshme.

Top Channel

Kryesore



Kokaina do t'i dorëzohej një personi në Astir/ Si u arrestuan dy "furnizuesit" mbrëmjen e djeshme, publikohen fotot e tyre

🕒 10:36

Sot zgjidhet kreu i ri/ Arben Kraja mesazh për tre kandidatët: SPAK të vazhdojë të përmbushë detyrimet ligjore

🕒 09:54

Emri/ Tentoi të vriste një person pas konfliktit për pronat, arrestohet 46-vjeçari

🕒 10:19

Krimet e pretenduara të luftës në Kosovë, ish-komandanti i UÇK-së dënohet me 26 vite burg

🕒 08:26

Më të lexuarat

Petro ndihet fajtor, Irisi e inatosur pas goditjes që i dha Lea! Çfarë ndodhi pas sherrit banal në studio, pezullohen tre konkurrentë

Në gjendje të demoralizuar, çfarë i ka ndodhur Fjoralba Ponarit?

Ish-marinisi vrasës-përdhunues porosit mish derri, zarzavate si vakt të fundit para ekzekutimit (fotot)

Fiks Fare/ Makina të reja? Dogana vendos çmime reference që pengojnë qytetarët të sjellin mjete të reja!

Nëna e tre fëmijëve qëllon për vdekje dy policë në parkingun e hotelit në Mississippi, SHBA (fotot)

Ishte denoncuar i humbur pesë ditë më parë nga i ati, gjendet i vdekur 35-vjeçari në Lushnjë

Emrat/ Detajet nga operacioni antdrogë në Astir! Cilët janë dy personat e arrestuar me mbi 2 kg kokainë

Serbia të nxehtet sa të dojë, Escobar: Kosova duhet të jetë në BE!

Anila Hoxha: SPAK "mbylli sytë" për Ahmetajn/ Ngjela: Çështje penale shumë e vështirë për t'u aprovuar

Gripi po godet më shumë/ Një variant i virusit respirator po prek më rëndë fëmijët

Aktualitet »



Kokaina do t'i dorëzohej një personi në Astir/ Si u arrestuan dy "furnizuesit" mbrëmjen e djeshme, publikohen fotot e tyre

🕒 16/12 10:36



Në garë për kreun e SPAK, Adnan Xholi: Koha të forcojmë besimin e Prokurorisë së Posaçme. Do duhen hetime konkrete, në kohë të shpejtë

🕒 16/12 10:22



Emri/ Tentoi të vriste një person pas konfliktit për pronat, arrestohet 46-vjeçari

🕒 16/12 10:19



Situata në Lezhë, 340 hektarë tokë e përmbytur nga reshjet

🕒 16/12 10:12



Sot zgjidhet kreu i ri/ Arben Kraja mesazh për tre kandidatët: SPAK të vazhdojë të përmbushë detyrimet ligjore


🕒 16/12 09:54



Aksident me vdekje në Tiranë, ndërron jetë 35-vjeçari

🕒 16/12 08:40

Kryesore »



Kokaina do t'i dorëzohej një personi në Astir/ Si u arrestuan dy "furnizuesit" mbrëmjen e djeshme, publikohen fotot e tyre

🕒 16/12 10:36



Rusia kryen sulm masiv me raketa në Ukrainë, humbin jetën dy persona

🕒 16/12 10:28




Në garë për kreun e SPAK, Adnan Xholi: Koha të forcojmë besimin e Prokurorisë së Posaçme. Do duhen hetime konkrete, në kohë të shpejtë

🕒 16/12 10:22



Emri/ Tentoi të vriste një person pas konfliktit për pronat, arrestohet 46-vjeçari

🕒 16/12 10:19



Gjermania parashikon mbikapacitet në терминаlet e gazit LNG

🕒 16/12 10:13




Sot zgjidhet kreu i ri/ Arben Kraja mesazh për tre kandidatët: SPAK të vazhdojë të përmbushë detyrimet ligjore

🕒 16/12 09:54

Na ndiqni:



Video »



Top Channel/ Paketa 9 e sanksioneve kundër Rusisë, BE ndihmë 18 mld euro dhe për Ukrainën



Top News – Ferr flakësh në Lion të Francës... / Humbin jetën dhjetë persona, mes tyre pesë fëmijë



Top News – Nuk ka më kthim pas/ Ndahen pas 9 vitesh, Wanda Nara dhe Mauro Icardi



Top News – Johnny Depp vishet si Jack Sparrow/ Aktori befason në spital 11 vjeçarin e sëmurë



Top Channel/ Vrau babë e bir në Grykë Zezë të Lezhës, kapet autori i ngjarjes



Top Channel/Solidaritet me më të varfërit/Veliaj:Thirrje të rinjve për të ndihmuar ata në vështirësi

Lajme

Politikë
Kronikë
Aktualitet
Ekonomi
Sociale
Video
Top News LIVE

Bota

Koment
Kosova
Rajoni
Teknologji
Auto

Sport

Futboll
Kombëtarja
Formula 1
Tregu i Futbollit

Pop News

Showbiz
Lifestyle
Fashion
Shëndeti
Dieta
Receta gatimi

Programe

Dancing with the stars
Përputhen
Shqipëria LIVE
Fiks Fare
Video
Të gjitha programet
Guida TV

Top Channel

Rreth Top Channel
Kontakt
Puno në Top Channel